

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Muzeve, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, në bashkëpunim me DRTK Gjirokastrë, Njësinë Bazë të Historisë, Antropologjisë dhe Gjeografisë, si dhe Fakultetin Ekonomik, zhvilluan aktivitetin me temë: "E ardhmja e muzeve në komunitetet që po ndryshojnë shpejt"

Temat që u trajtuan në aktivitet:

- Muzetë mbështesin ekonominë lokale duke krijuar mundësi punësimi dhe duke ofruar programe edukative që fuqizojnë komunitetet.
- Duke nxitur kreativitetin dhe duke përqafuar parimet teknologjike, muzetë nxisin inovacionin dhe rrisin aksesueshmërinë.
- Muzetë kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm urban duke vepruar si qendra kulturore që promovojnë përfshirjen, qëndrueshmërinë dhe ruajtjen e trashëgimisë.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte njohja e studentëve me rolin e muzeve në një botë në ndryshim, duke u fokusuar te kontributi i tyre në zhvillimin kulturor, ekonomik dhe teknologjik të komunitetit lokal.

Të pranishëm ishin studentë të degës Histori, Antropologji dhe Gjeografi, studentë nga degë të ndryshme të Fakultetit Ekonomik, si dhe pedagogët përfaqësues.



